

SHTOJCE NR. 1

Tiranë, më: 27.12.2019

**“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt:
“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”**

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, me objekt: **“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”** dhe me fond total të marrëveshjes kuadër në vlerën prej 166,856,450.4 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë katër) lekë pa TVSH dhe REF-45458-12-03-2019, hartoi këtë shtojcë për mirë përcaktim të dokumenteve të tenderit, si më poshtë:

Në dokumentet e tenderit, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”:

Tek pika 3.3, Kapaciteti teknik, nënpika 3:

ISHTE:

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi, huapërdorje ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**

- Kontratë qiraje.

- a) leje qarkullimi,
- b) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- c) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

d) akt miratimi higjeno – sanitar.

BËHET:

4. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi, huapërdorje ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**

- Kontratë huaje.

➤ **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**

- Kontratë qiraje.

a) leje qarkullimi,

b) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

c) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

d) akt miratimi higjeno – sanitar.

Në zbatim të pikës 2/1 të nenit 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, me objekt: **“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”** dhe me fond të marrëveshjes kuadër në vlerën prej 166,856,450.4 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë katër) lekë pa TVSH dhe REF-45458-12-03-2019, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, shtyhet për në **datën 06.01.2020 ora 14:00.**

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.